



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**  
Opština Prishtina - Municipality of Prishtina



Bazuar në Planin e aktiviteteve të Projektit **“Tregu i Luleve”**, Komuna e Prishtinës, shpall:

### **KONKURS PROJEKTIMI**

Për hartimin e projekt – propozimit arkitektonik **“Tregu i Luleve”** në Prishtinë

**14 mars – 05 prill 2016**

Komuna e Prishtinës fton të gjithë të interesuarit e profilit të Arkitekturës dhe Dizajnit të Enterierit (kompani, arkitekt / dizajner i/e diplomuar), të konkurojnë për projekt - propozimin arkitektonik për **“Tregun e luleve”** në Prishtinë si pjesë e planit të aktiviteteve të projektit **“Tregu i luleve”** në Prishtinë.

Tregu i luleve është planifikuar të në Sheshin **“Skënderbeu”**, konkretisht në pllantonë përballë ndërtesës së Qeverisë prapa shtatores së Skënderbeut në Prishtinë dhe ku kopshtarët do të mund të shesin dhe promovojnë lloje të ndryshme të luleve.

Të gjitha koncept projektet që do të konkurojnë në këtë konkurs, do të vlerësohen nga një juri profesionale. Procesi i përzgjedhjes do të bëhet nëpërmjet vlerësimit të Koncept Projekteve në bazë të përgjegjshmërisë së tyre, sipas kërkesave teknike dhe/ose estetike, duke aplikuar kriteret e vlerësimit, nën-kriteret, dhe sistemin e pikëve të caktuara nga juria profesionale. Pas vlerësimit të Koncept Projekteve, juria do të shpallë tre fituesit e këtij konkursi, të cilët do të shpërblehen me çmime fituese.

Për informacion më të detajuar ju lutem kontaktoni Zyrën e Prokurimit në Komunën e Prishtinës.

Shpalljen mund ta gjeni në:

<http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=114162>

